



Të lexosh Lolitën në Teheran

Description

Të lexosh Lolitën në Teheran: Informatorët 'autoktonë' dhe projektet perandorake – Hamid Dabashi

[...] MUND TË ARGUMENTOHET gjithashtu se ky akt i *amnezisë kolektive* shoqëron një strategji të *kujtesës selektive* – dy raste patologjike që, në fakt, zmadhojnë dhe konfirmojnë njëra tjetrën. Një rast veçanërisht i fuqishëm i kujtimeve të tilla selektive është tanimë plotësisht i qartë në një korpus gjithnjë e në rritje kujtimesh, apo autobiografish, nga njerëz prej një të kaluarë e formimi islam që gjatë gjysmë dekadës së fundit, që nga fillimi i “Luftës ndaj Terrorizmit”, ka përmbytur tregun e librave të Shteteve të Bashkuara. Ky korpus literature, ndoshta i përfaqësuar më së miri nga *Reading Lolita in Teheran* (2003) (*Të lexosh Lolitën në Teheran*) e Azar Nafisi-t, zakonisht e vë theksin mbi shqetësime legjitime në lidhje me gjendjen e vështirë të grave myslimane në botën islame, dhe, megjithatë, e vendos këtë angushti sheshazi në shërbim të operacionit psikologjiko-ideologjik të SHBA-së, ushtarakisht e përcaktuar në luftënxitjen globale amerikane. Siç ka treguar në mënyrë të përsëritur presidenti Bush, SHBA-ja është e angazhuar tashmë në një luftë të zgjatur me terrorizmin, dhe së cilës nuk i shihet fundi. Ky terrorizëm ka një natyrë dhe prejardhje të pretenduar “islame”. “Islami” në këtë lexim të veçantë është i ulët, i dhunshëm, dhe mbi të gjitha abuziv me gratë – dhe, kësaj, të luftosh kundër terrorizmit islam, *ipso facto*, do të thotë gjithashtu të shpëtosh gratë myslimane nga e keqja e burrave të tyre. “Burra të bardhë që shpëtojnë gra zeshkane nga burra zeshkanë,” sikundër e formulon feministja e spikatur postkoloniale Gayatri Spivak (Gajatri Spivak) në esenë e saj revolucionarizuese: “Can the Subaltern Speak?” (“A mund të flasë subalternja?”)

Tre vjet mbas botimit të *Reading Lolita in Teheran* të Azar Nafisi-t, dhe pikërisht në mes të një shqetësimi global në lidhje me një tjetër operacion ushtarak amerikan në rajon, mund të shihet tashmë qartë dhe të sugjerohet se ky libër është pjesërisht përgjegjës për të kultivuarit e opinionit publik amerikan kundër Iranit (dhe, rrjedhimisht, edhe atij global), duke qenë se prej kohësh kishte bërë një punë të madhe duke u bërë një mjet kyç propagandistik në dispozicion të administratës Bush gjatë luftërave të saj të tejzgjatura në vende myslimane, si Afganistani (që nga viti 2001) dhe Iraku (që nga viti 2003). Një shqyrtim më nga afër i këtij teksti zbulon, kësaj, shumëçka në lidhje me mënyrën se si operojnë projektet perandorake amerikane në domenet e saj specifiku islame.

Botimi i *Reading Lolita in Tehran* e Azar Nafisi-t përkoi me periudhën më luftarake në historinë e vonë të SHBA-së, me shpërfaqjen globale të muskujve të saj ushtarakë, dhe, si i tillë, teksti në fjalë ka marrë një domethënie proverbiale në mënyrën sipas së cilës informatorët autoktonë, të shndërruar në

intelektualë të shitur, u shërbejnë një funksioni thelbësor në të mundësuarit e miratimit publik për kryelartësinë perandorake. Me një gur të vetëm, Azar Nafisi ka arritur jo dy, po tre objektiva të njëkohshëm: (1) denigrimin sistematik dhe të palëkundur të një kulture të pandërprerë të rezistencës revolucionare ndaj një historie të kolonializmit mizor; (2) realizimi i kësaj nëpërmjet të avancuarit haptazi të terrenit të presupozuar kulturor të një perandorie grabitqare; dhe (3) ndërkohë, që në po të njëjtën kohë, ka ushqyer forcat më prapanike dhe reaksionare brenda Shteteve të Bashkuara, duke ndërmarrë një luftë të gjithanshme ndaj krenarisë së bashkësivë e ndryshme të imigrantëve dhe pakicave të raciaizuara që kërkojnë njohje në programet kurrikulare të kampuseve universitare, dhe në shoqërinë amerikane në tërësi.

Për sa i përket urrejtjes së patundur ndaj gjithçkaje iraniane – që nga kryeveprat e saj letrare deri te njerëzit e saj të zakonshëm – që nga koha e librit famëkeq të Betty Mahmoody *Not Without My Daughter* (Jo pa bijën time) nuk ka tekst që të ketë shpërfaqur një urrejtje sistematike kaq të thellë ndaj gjithçkaje iraniane. Ndërkohë, duke kërkuar që të riciklojë një version *kaffeeklatsch* (“kafe e muhabet”) të letërsisë angleze si terrenin ideologjik të perandorisë amerikane, *Reading Lolita in Tehran* të sjellë në kujtesë projektet më molepsëse koloniale të britanikëve në Indi, kur, për shembull, në vitin 1835 një officer kolonial si Thomas Macaulay dekretoi: “Ne duhet të bëjmë çmos për t’i dhënë trajtë një klase që mund të jenë interpretues ndërmjet nesh dhe atyre milionave që ne qeverisim, një klasë personash që janë indianë në gjak dhe ngjyrë, por anglezë në shije, opinione, fjalë dhe intelekt.” Azar Nafisi është personifikimi i këtij informatori naiv dhe agjenti kolonial, duke i rafinuar shërbimet e saj për një version amerikan të po të njëjtit projekt.

Brenda përbrenda Shteteve të Bashkuara, *Reading Lolita in Tehran* promovon kauzën e “Klasikëve Perëndimorë” në një kohë kur dekada të përpjekjes nga feministet, studiuesit dhe aktivistët postkolonialë zezakë dhe të Botës së Tretë ia ka arritur më në fund që të ndërfusë një sasi të vogël vëmendjeje ndaj letërsive të botës. Arritja e të gjitha këtyre, ndërkohë që ajo ka qenë e punësuar nga Sekretari i Mbrojtjes i SHBA-së Paul Wolfowitz, e indoktrinuar nga babai i neokonservatorëve amerikanë Leo Strauss (dhe pamfleti i tij i turpshëm *Persecution and the Art of Writing* (Persekutimi dhe Arti i të Shkruarit), e instruktuar nga artisti shiit libanez, neokonservatori Fouad Ajami (Fuad Axhami), përzemërsisht e përkrahur nga Bernard Lewis (ideologu më i djallëzuar i luftës së SHBA-së ndaj myslimanëve), ky është një goxha akt heroik për një ish-profesoreshë të letërsisë angleze pa asnjë libër të vetëm të besueshëm apo pa asnjë kredencial të vetëm prej studiuese në emrin e saj përveç *Reading Lolita in Tehran*.

Libri i Azar Nafisi-s është kësodore *locus classicus* (vatra klasike) e terrenit ideologjik të dominimit perandorak të SHBA-së brenda dhe jashtë vendit në tre lëvizje të njëkohshme: (1) ai mbështetet në një amnezi kolektive të fakteve historike që rrethojnë lëvizje të njëpasnjëshme imperialiste amerikane për dominim global – sepse mbizotëruese në *Reading Lolita in Tehran* është një mungesë e dukshme e historikes dhe një shpëlarje haptazi e letrares; (2) libri ilustron me vetë shembullin e tij abuzimin sistematik të kauzave legjitime (në këtë rast, shtypjen e papërmbajtur të grave që jetojnë nën ligjet myslimane) për qëllime ilegjitime; dhe (3) nëpërmjet instrumentalitetit të letërsisë angleze, i ricikluar dhe i nyjëtuar nga një grua “orientale” e cila qëllimisht e modelon veten si një Sherazade bashkëkohore, libri mëton të provokojë qoshet më të errëta të fantazive orientale euro-amerikane dhe kësodore të neutralizojë vendndodhjet konkurruese të rezistencës kulturore ndaj projekteve perandorake amerikane si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij, ndërkohë që, *ipso facto*, duke denigruar përpjekjen e gjatë dhe fisnike të grave në mbarë botën e kolonizuar për të siguruar të drejtat e tyre si kundër patriarkisë vendase ashtu dhe ndaj dominimit kolonial. Në rastin e dytë, projekti i *Reading Lolita in Tehran* është vetëm në sipërfaqe i kufizuar në të denigruarit e kulturave letrare dhe lëvizjeve feministe iraniane dhe, rrjedhimisht, islame; shënjestra e tij njëlloj e rëndësishme është të flakë tutje

dhe të diskreditojë kulturat konkurruese jo të bardha të komuniteteve imigrante, që variojnë që nga afro-amerikanët, deri te aziatiko-amerikanët, e latino-amerikanët, dhe pakicat e tjera të raciaizuara.

Rrallëherë ka arritur një shërbëtor oriental i një projekti perandorak të identifikuar si të bardhë që të paketojë kaq shumë shërbime për kryelartësinë perandorake dhe elitizmin racist në vendin e tij – gjithçka në një akt të vetëm. Kësodore, është jashtëzakonisht e rëndësishme që Nafisi të lexohet jo thjesht për shërbimet e saj ideologjike ndaj projekteve perandorake amerikane në rrafsh global, por, njëlloj, në mos më e rëndësishme, për pasojat e saj reaksionare brenda përbrenda Shteteve të Bashkuara gjithashtu.

Në sipërfaqe, *Reading Lolita in Tehran* e Azar Nafisi-t ka një fabul mjaft të thjeshtë. Një profesoreshë e letërsisë angleze në një universitet iranian, e lindur në një familje të privilegjuar dhe kësisoj e arsimuar në Europë dhe Shtetet e Bashkuara, nuk i honeps më kufizimet e egra të një republike islamike, dhe jep dorëheqjen nga posti i saj. Ajo kthehet në shtëpi, grumbullon shtatë prej studenteve të saj më të shkëlqyera femra, dhe ato bëhen bashkë e lexojnë disa prej kryeveprave të “letërsisë perëndimore”, ndërkohë që i lidhin personazhet dhe ndodhitë e romaneve që ato lexojnë me angushtitë e tyre të përditshme në republikën e kalbëzuar islamike. Fabula, e bazuar në ngjarje të vërteta apo e trilluar apo një ndërthurje e të dyjave, ofron një rast për narratorin që të japë një dënim gjithëpërfshirës jo thjesht të revolucionit islamik, por tok me të edhe të të gjithë kombit, të të varfërve dhe të gjithë atyre që janë zhveshur nga të drejtat, që i ka dhënë hov atij – për të cilin ajo nuk ka absolutisht asgjë përpos përbuzjes plot neveri. Për të lidhur këtë fabul të thjeshtë dhe shërbimet e saj të zgjeruara me operacionet perandorake të SHBA-së brenda dhe jashtë vendit, ne na nevojitet një kornizë teorike më e gjerë që gjen referenca në studimet e letërsisë krahasimore.

Në studimin që ai i bën terrenit të imperializmit, *Culture and Imperialism* (1993), (*Kultura dhe Imperializmi*), Edward Said ka shqyrtuar territoret e mbivendosura, siç i ka quajtur ai ato, ndërmjet letrares dhe politikës, kulturores dhe perandorakes, në imagjinaren perandorake euro-amerikane. Kjo, sikundër ai nuk lodhej kurrë së përsërituri, nuk do të thonte që të reduktohej literatura evropiane në tendencat politike të ndonjë periudhe të caktuar, por në fakt, anasjelltas, që të parashtrohej fakti politik, thënë me hermeneutikën e tij proverbiale, si interlokutori parësor i ngjarjes letrare – të letërsisë evropiane të periudhës në veçanti.

Në veprën e saj ngjashëm revolucionare mbi marrëdhënien ndërmjet politikave të brendshme dhe të huaja të një perandorie dhe manifestimet e tyre kulturore, *The Anarchy of Empire in the Making of US Culture* (2002), *Anarkia e Perandorisë në Berjen e Kulturës së SHBA-së* (2002), Amy Kaplan ka treguar hallkën lidhëse ndërmjet punëve të brendshme dhe atyre të jashtme në fabrikimin e një projekti të tillë perandorak. Në këtë vepër të jashtëzakonshme të hulumtimit letrar, Ami Kaplan tregon se si të paktën që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe nisja e luftrave të njëpasnjëshme me Meksikën, Spanjën, Kubën dhe Filipinet, ekspansionizmi imperialist amerikan është ngushtësisht i lidhur me çështje të tilla të politikës së brendshme, si raca, klasa dhe gjinia.

Nga ana tjetër e të njëjtit argument, në studimin e saj hulumtues që çel udhë të reja studimore, *Masks of Conquest: Literary Study and British Rule in India (Maskat e Pushtimit: Studimi Letrar dhe Sundimi Britanik në Indi)* Gauri Viswanathan e ka gjurmuar zanafillën e ngritjes së studimeve letrare angleze në origjinat e tyre koloniale në Indi, dhe si një strategji efikase e kontrollit kolonial. Studimi i letërsisë angleze, siç ka treguar me mjeshtëri Viswanathan, si në lëndën ashtu dhe në metodën e pretendimeve të tij letrare, ka qenë instrumental në lehtësimin e sundimit britanik nëpërmjet edukimit të një gjenerate të indianëve, të cilët, siç është shprehur Macaulay, ishin “indianë në gjak dhe ngjyrë, por anglezë në shije, opinione, fjalë e intelekt.”

Që nga Edward Said e deri te Amy Kaplan dhe Gauri Viswanathan, ne tanimë kemi një korpus të qëndrueshëm studimor, i shtrirë nga SHBA, kaluar Evropës, e deri në Indi, dhe me nënkuptim teorik në mbarë botën e kolonizuar, një argument bindës për atë se si të mësuarit e letërsisë angleze ka qenë historikisht definitive për tendencat imperialiste britanike, dhe sot, për rrjedhojë, për ato amerikane. Sërish, asnjëri prej këtyre studiuesve dhe teoricienëve nuk e ka reduktuar letraren në politike, por thjesht kanë parashtruar një interlokutor politik pranë veprës së letërsisë nëpërmjet një provokimi hermeneutik të të kuptuarit dhe domethënies – me pothuajse të njëjtën simbolikë që dikush mund të vendosë një kritikë feministe apo antiraciste e po të njëjtave tekste, pa mohuar apo kompromentuar rëndësinë e tyre letrare.

Botimi i *Reading Lolita in Tehran* e Azar Nafisi-t është rasti bashkëkohor më i mirargumentuar i një tjetër tentative për ta parashtruar letërsinë angleze edhe njëherë si një *modus operandi* e të fabrikuarit të pëlqimit kulturor trans-rajonal për dominimin global euro-amerikan. Evidencat faktike të lidhjes së Azar Nafisi-t me liderët amerikanë të lëvizjes neokonservatore dhe përbuzja që ajo rezervon për kulturën iraniane, dhe, si rrjedhojë, për kulturat lokale dhe rjonale të qëndruesës ekzistuese apo potenciale ndaj perandorisë amerikane, duke glorifikuar në vend të tyre një hijerore të brendshme të kanonizuar për një kremtim ikonik të “letërsisë perëndimore”, janë faktorë shtesë në vendosjen e saj qartazi në shërbim të perandorisë grabitqare amerikane – ky shërbim jepet nëpërmjet invokimit më të nxitur nga klishtëtë të fantazive më prapanike orientale të lexuesve të saj në Shtetet e Bashkuara dhe Europë.

Duke pasur parasysh natyrën transnacionale të perandorisë së globalizuar, një funksion vendimtar i terrenit të saj ideologjik pohohet në rolin që mund të luajnë intelektualët e mërguar. Transmutacioni i Azar Nafisi-t nga një kritike legjitime e mizorive të Republikës Islamike të Iranit (kundër grave në veçanti) në një ideologje të domosdoshme në projektin e George W. Bush për sendërtimin e perandorisë është një leksion vendimtar i asaj se si një racë e re e intelektualëve të shitur po rekrutohet e po vihet në përdorim të menjëhershëm për sendërgjimin ideologjik të një pretendimi përndryshe të paqëndrueshëm për hegjemoni perandorake.

Menjëherë mbas 11 shtatorit, intelektualët autoktonë të shitur u rekrutuan në mënyrë aktive për të kryer një funksion vendimtar për ideologët militantë të Perandorisë SHBA. Detyra e tyre është të shtiren se kanë autoritet, autenticitet dhe njohje autoktone, dhe, kësodore, të informojnë publikun e SHBA-së për mizoritë që po ndodhin anembanë botës, në rajonin e vendit të tyre lindjes në veçanti, duke justifikuar projektet perandorake të SHBA-së sikur ato janë çliruese të këtyre vendeve nga e keqja e vetë projekteve që ato kanë.

Si të gjitha aktet e tjera të propagandës dhe dezinformimit, *Reading Lolita in Tehrani* sendërtohet mbi një element të së vërtetës. Republika Islamike e Iranit ka një histori brutale të të ndrydhurit, të heshturit, dhe të ekzekutuarit të drejtëpërdrejtë të intelektualëve sekularë, ndërkohë që ka krijuar sistematikisht dhe ligjërish një shtet të aparteidit gjinor. Por funksioni i intelektualit të shitur është që të

mos ekspozojë dhe të përballet me mizori të tilla; përkundrazi, funksioni i tij është ta marrë këtë element të së vërtetës dhe ta paketojë atë në një mënyrë që i shërben më së miri perandorisë luftënxitëse: Nën petkun e një kritiku legjitim të tiranisë së lokalizuar ai lehtëson, kështu, operimin e një dominimi global shumë më tinëzar – efektivisht duke përjetësuar (dhe përnjëmend duke përkeqësuar) terrorin e brendshëm që ai synon të ekspozojë.

Për shkak se terreni natyral për operimin e intelektualëve të shitur, besnik ndaj origjinës së termit në lehtësimin e transaksioneve tregtare, është morali i shtresës së mesme të vendit të tyre bujtës (tanimë i shndërruar në një perandori), aluzioni dhe insinuata janë ndër troposet e operacioneve të tyre. Deri më sot, aspekti më imediat dhe më intrigues i *Reading Lolita in Tehran* është kopertina e saj, e cila tregon dy adoleshente femra që kanë përkulur kokën në një gjest të qartë ku duket se po lexojnë diçka. Se çfarë po lexojnë ato me saktësi, ne as nuk e shohim dhe as nuk e dimë. Mbi kryet e tyre ne lexojmë “Reading Lolita in Tehran” (“Të lexosh Lolitën në Teheran”). Ajo që sugjerohet aty për aty është mjaft e thjeshtë. Tema e librit kuptohet se është leximi i librit “*Lolita*” e Vladimir Nabokov në Teheran, dhe në pamje janë dy adoleshente me dukje si iraniane me shami veshur duke lexuar (një gjë apo një tjetër).

Reading lolita cover

Image not found or type unknown

Dy vajzat e reja duket se janë të angazhuara plot hare në atë që ato po lexojnë, dhe ato e bëjnë këtë në një mënyrë kaq të përzemërt saqë kjo ngjall simpati, dhe madje edhe evokon bashkëfajësi. Ç’pamje më e mirë mund të përfaqësojë këtë ide – duke ia lënë imagjinatës së vëzhguesit se ato po lexojnë në të vërtetë Lolitën e Nabokovit? Saktë? Gabim!

Një çast pauze mbi këtë kopertinë fillon të zbulojë diçka krejtësisht të ndryshme. Nën parullën e *Reading Lolita in Tehran (Të lexosh Lolitën në Teheran)* imazhi dhe diçitura të vendosura së bashku – në një rast klasik të lexuara dhe analizuara më së miri nga Roland Barthes në esenë e tij të shkëlqyer “Mesazhi Fotografik” – sugjeron shtesën ngashënnyese të një përdredhjeje orientale për rastin më famëkeq të pedofilisë në imagjinatën letrare moderne. Edhe si një shenjë sociale ashtu si edhe si shënjes, termi “Lolita” evokon seks të paligjshëm me adoleshentet. Kryet e mbuluara të këtyre dy adoleshenteve iraniane, pra, në mënyrë sugjestionuese huazojnë dhe tinëzisht ndërsejnë një fantazi orientale fantazmagorike dhe ia japin hua atë rastit më të përflakur të pedofilisë në imagjinatën letrare moderne. Nën rubrikën që ai e quajti një *paradoks fotografik*, Barthes jep një diagnozë të shkëlqyer se si arte të tilla imitative si fotografia « përbëjnë dy mesazhe : një mesazh të *treguar*, i cili është vetë *analogon-i*, dhe një mesazh të *nënkuptuar*, i cili është lënda në të cilën shoqëria deri njëfarë mase

komunikon atë çka mendon rreth tij. » (Roland Barthes, “The Photographic Message,” in *A Barthes Reader*. Hills and Wang, 1982: 195-198).

Mesazhi *i treguar* këtu duket se është mjaft i qartë: këto dy gra po lexojnë “Lolita” në Teheran – ato po lexojnë (“Lolita’), dhe ato janë në Teheran (ato duken iraniane dhe ato kanë shami në kokë). Mesazhi *i nënkuptuar* është njëlloj i vetëkuptueshëm: Pa imagjinoje pak – seks i paligjshëm me adoleshente në një Republikë Islamike! Si ju duket kjo, propozon në mënyrë sugjestionuese kopertina, dhe pyet, a mund të imagjinojnë të lexoni *Lolitën* në Teheran? Shikoni këto dy Lolita orientale! Implikimi racist i sugjerimit – a thua se me habi shtrohet pyetja, “a mund t’ju shkojë ndërmend të lexoni këtë roman në atë vend?” – konkurron me pedofilinë e tij haptazi të orientalizuar dhe turbullon transparencën e një strategjie marketingu që u drejtohet fantazive më të sfazuara orientale të një kombi prej kohësh të ngurtësuar, pavarësisht nga zgjuarësia e tij, nëpërmjet një lufte të egër të shpallur kundër një potence mashkullore arabo/myslimane fantazmagorike që sapo ka tredhur shtyllat totem të perandorisë amerikane në Nju Jork.

Një nga klisjetë më të zakonshme të Orientit të dëshirueshëm janë djemtë e vajzat e mitura, të inskenuar në shumë piktura orientaliste. Leila (1892) e Sir Frank Dicksee dhe “Safie, One of the Three Ladies of Baghdad” (“Safija, një nga tri hanëmet e Bagdadit”) (pa datë) janë ndër gjurmët më imediate arkeologjike të kopertinës së *Reading Lolita in Tehran*, ku ajo vetë është një përditësim fotografik i një tradite të gjatë në pikturën orientaliste.

Po aq e qartë në këtë kopertinë është i gjithë zhanri i pamjeve të kartolinave koloniale të grave të reja algjeriane – të inskenuara, të prodhuara dhe të blera nga oficerët kolonialë francezë. Malek Alloula ka studiuar këto foto në *The Colonial Harem* (1995) (*Haremi kolonial*). Në studimin që u bën këtyre fotografive të fabrikuara në mënyrë kolonialiste, Malek Alloula ka treguar se si fantazma patologjike koloniale gjeneroi dhe mbajti në këmbë atë që Barthes e ka quajtur “grada zero” e evidencës fotografike për të përfaqësuar dhe zotëruar trupin e kolonizuar. Më duket profetike, po të mos ishte kaq e pahijshme, që në hapësirën e kopertinës së parme dhe asaj të pasme të *Reading Lolita in Tehran* ne kemi një orientalizëm të përditësuar pedofil të dokumentuar kaq përmbledhtazi: në ballinën e parë pamja e dy “vajzave” adoleshente iraniane me shami, dhe në kopertinën e pasme nënshkrimin e vetë Profesorit Humbert Lewis të orientalizmit.

Akti evident i të provokuarit të këtij tipari kolonial mbi kopertinën e librit të Azar Nafisi-t nuk është fundi i asaj që bën kjo kopertinë. Aty ka edhe më tepër, madje shumë më tepër. Në fakt, rasti i kësaj kopertine ofron një përdredhje intrigues mbi kundërvënien binare që paraqet Roland Barthes ndërmjet mesazheve të treguara dhe të nënkuptuara të një fotografie dhe diçitursë së saj. Përdredhja ngrihet mbi faktin se pamja e këtyre dy adoleshenteve mbi kopertinën e *Reading Lolita in Tehran* është, në fakt, e marrë nga një kontekst krejtësisht i ndryshëm. Fotoja origjinale nga e cila kjo kopertinë është prerë është marrë nga një raportim lajmi gjatë zgjedhjeve parlamentare të shkurtit 2000 në Iran. Në pamjen origjinale, dy vajzat e reja po lexojnë, ç’është e vërteta, gazetën kryesore reformiste *Mosharekat*. Azar Nafisi dhe botuesi i saj mund të kenë menduar se bota nuk sheh, dhe se ata mund të shtrembërojnë historinë e një populli në cilëndo mënyrë që ata dëshirojnë. Por pamja origjinale nga e cila kjo kopertinë e vjedh idenë e saj flet për faktin e këtij falsiteti.

Reading Lolita real cover

Image not found or type unknown

Kopertina e *Reading Lolita in Tehran* është një vjedhje ikonike nga shtypi, e shtrembëruar dhe e inskenuar në një kornizë për një qëllim krejtësisht të ndryshëm nga ai kur është shkrepur fotografia. Në formën dhe inkuadrimit e saj të shtrembëruar, pamja është e qethur, kështu që ne nuk e shohim më gazetën që dy studentet vajza të reja po mbajnë në duar, duke krijuar kësodore iluzionin se ato janë “Duke lexuar Lolitën” – me shamitë e dy adoleshenteve që bëjnë detyrën e frazës “në Teheran”. Në pamjen origjinale, dy studentet e reja duket qartë se janë në një kampus kolegji, duke lexuar një gazetë që po raporton rezultatet më të fundit të një palë zgjedhjeve kryesore parlamentare në vendin e tyre. Duke qethur gazetën, duke qethur shoqet e klasës pas tyre, dhe duke qethur një fotografi përsosmërisht të dukshme të Presidentit Khatami – përfaqësuesi ikonik i lëvizjes reformiste — dhe duke sugjeruar se dy gratë e reja po lexojnë “Lolitën”, i zhvesh ato nga intelijenca e tyre morale dhe pjesëmarrja e tyre në aspiratat demokratike të atdheut të tyre, duke i shtytur ato drejt një haremi kolonial.

Në epokën e “fundit të historisë”, sikundër e ka teorizuar sivëllai ideologjik neokonservator i Azar Nafisi-t, Francis Fukuyama, funksioni i intelektualit të shitur është që të shërbejë siç duhet, duke ndihmuar në fshirjen e të gjitha historive kombëtare, dhe duke ofruar një rrëfenjë argëtuese për të mbushur zbrazëtinë. Megjithatë, argëtimi duhet të jetë i mburitur me një joshje masive. Përmbajtja e *Reading Lolita in Tehran*, pra, barabitet me kopertinën e saj – të dyja i shërbejnë menjëherë kontekstit imperial në mënyrën e duhur. Me historinë të lënë pezull, më kot e lexon një njeri këtë libër në kërkim të madje edhe një bashkëbisedimi të vetëm me ndonjë teori letrare relevante të grumbulluar për breza më radhë rreth veprave të autorëve që mbajnë lidhur katër kapitujt e librit në mënyrë narrative – Nabokov, Scott Fitzgerald, Henry James, dhe Jane Austen. *Reading Lolita in Tehran* është një tekst çuditërisht i ngushtë kulturalisht, jo vetëm me prirjen për të qenë harrestar ndaj historisë, shoqërisë, dhe kulturës iraniane, por njëloj i shkëputur nga bibliotekat e komentareve dhe analizave të akumuluar për breza me radhë përreth dhe në lidhje me autorët e librat që ajo diskuton. Por kjo lënie jashtë përputhet si mos më mirë me atë që teksti është autorizuar që të bëjë – gjegjësisht t'i ofrojë një game të gjerë lexuesish të njëvlershmin funksional të një rrëfimi që përfaqëson historinë, që lexohet si fikcion, dhe që shtrembëron realitetin teksa pretendon se e rrëfen atë.

Megjithatë, në botën e vërtetë, nuk ka, sigurisht, asgjë të re apo të jashtëzakonshme në lidhje me iranianët që lexojnë vepra të letërsisë artistike të çdo lloji nga përçark botës si një akt i mosbindjes politike. Këtu sërish, Azar Nafisi vijon të qethë pamjen që ajo portretizon brenda librit të saj në një mënyrë të ngjashme me vjedhjen pamore që ajo dhe botuesi i saj kryejnë në kopertinën e librit – duke vjedhur kësodore një pjesë të së vërtetës për të treguar një gënjeshtër më të madhe. Nuk janë vetëm “klasikët perëndimorë”, siç sugjeron ky libër, që iranianët kanë lexuar në shenjë mosbindje politike ndaj tiranive militante sundimtare – qoftë Pahlevitë (në lidhje me mizoritë e tyre Nafisi ruan një heshtje totale) qoftë klerikët aktualë. Përgjatë gjithë shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe atij të njëzetë, vepra të mëdha të letërsisë nga mbarë bota kanë hijeshuar dhe pasuruar kulturën letrare dhe politike iraniane.

Në historinë e tyre më të vonë dhe në vazhden e modernitetit kolonial dhe duke filluar me Revolucionin Francez, iranianët kanë qenë sistematikisht dhe periodikisht të ekspozuar ndaj letërsisë botërore, ku secila herë, ç’është e vërteta, është shkaktuar nga një ngjarje e madhe revolucionare apo traumatike. Revolucionin Francez i vitit 1789 shkaktoi ekspozimin e iranianëve ndaj letërsisë franceze dhe asaj angleze. Revolucionet evropiane të vitit 1848 i joshën thellësisht intelektualët iranianë të mërguar në Stamboll, e cila gjë, nga ana tjetër, rezultoi në më tepër përkthime të burimeve franceze dhe angleze. Revolucionin Rus i vitit 1917 bëri të njëjtën gjë sa i takon letërsisë ruse; njëlloj sikundër ndodhi edhe me pushtimin amerikan të Iranit gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe më vonë me Luftën e Vietnamit dhe lëvizjen e të Drejtave Civile sa i përket letërsisë amerikane. Revolucionet latino-amerikane, lëvizjet anti-kolonialiste afrikane, nacionalizmi anti-kolonialist indian, Revolucionin Kinez, Revolucionin Kubanez, kryengritja studentore në Francë, etj... — këto janë pika të tjera referimi të ekspozimit Iranian ndaj letërsisë botërore, siç është njëlloj evidente në ekspozimin tonë ndaj letërsisë moderne arabe menjëherë mbas pushtimit kolonial të Palestinës dhe nacionalizmit naserit (të formuar në bazë të ideve të presidentit egjiptian Xhemal Abdyl Naser sh.p.). Azar Nafisi ose është injorante në lidhje me këto fakte historike, ose, përndryshe, ajo i fsheh ato – në cilindo rast ajo po qeth formën dhe kuadrin e vërtetë të gjitha kësaj tabloje të plotë, duke e tkurrur atë në një përmasë që është e dobishme për një riciklim aktiv të një leximi mjaft selektiv të letërsisë angleze.

Sikundër ka treguar Amy Kaplan në veprën e saj *Anarchy of Empire in Making of US Culture*, “kufijtë konceptualë ndërmjet të brendshmes dhe të jashtmes së vendit” janë artefaktet kryesore që perandoritë edhe ngrejnë edhe destabilizojnë. Paradoksi që Amy Kaplan artikulon është i zgjidhur në detyrën e dyfishtë që kryejnë intelektualët e shitur si në diskreditimin e kulturës së tyre autoktonë të rezistencës, dhe, *ipso facto*, duke neutralizuar në mënyrë të barabartë kulturat potente të rezistencës në gjirin e bashkësive imigrante dhe pakicave të raciaizuara në qendrat metropolitane të perandorisë. Pra, ka një tjetër axhendë apo rrjedhojë – jo kaq të fshehur – evidente në *Reading Lolita in Tehran*. Pas dekadash të një përpjekje të pareshtur kundër mbizotërimit të kurrikulës eurocentrike në akademinë amerikane, dhe luftës për të rivendosur një dinjitet demokratik në botën e skenës letrare, Nafisi edhe njëherë e shtyn orën pas për rreth gjysmë shekulli nëpërmjet një lëvdate të pazakontë dhe ekskluzive për eurocentricitetin e imagjinatës letrare.

Të promovuarit e kauzës raciste të një kanoni të vetëm letrar në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë shkon krah për krah me denigrimin, flakjen tutje apo shpërfilljen e ekzistencës së traditave letrare dhe kulturore jo-euro-amerikane. Askush nuk ka për ta mësuar ndonjëherë, duke lexuar *Reading Lolita in Tehran*, se iranianët, njëlloj si të gjitha kombet e tjera, kanë një letërsi të tyre, një yjësi të shkriemtarëve, poetëve, artistëve, aktivistëve dhe studiuesëve që nuk kanë të dytë, se ato janë të mbijetuara dhe ëndërrimtare në terma jo thjesht globale për gjeopolitikën e tyre, por gjithashtu edhe në terma të brendshëm në raport me vendin për rreziqet dhe premtimet e tyre, dhe se në harkun kohor të të njëjtës periudhë kohe (vitet 1990) që Azar Nafisi denjoi të jetonte në Iran dhe bëri përpjekje për të

shpëtuar shpirtin e një kombi duke u mësuar disa pak të privilegjuareve në mesin e tyre “Klasikët Perëndimorë”, iranianët kanë prodhuar një kinema të lavdishme që e ka shtangur në vend globin me drojë dhe admirim, ka prodhuar një shtyp dhe letërsi feministe që rrallëherë gjen të ngjashme në ndonjë vend tjetër, dhe kanë zgjedhur më tepër gra në parlamentin e tyre se sa ato në Shtetet e Bashkuara. Çrrënjësia narrative e letërsisë perse dhe kulturës iraniane ndërkohë që shkruan në një kontekst krejtësisht iranian shndërrohet në një flakje tutje më globale të letërsive botërore në tërësi, të çdo letërsie apo kulture që mund të ndalë dhe parashtrijë një element qëndrësor ndaj projekteve perandorake dhe terrenit të tyre ideologjik.

Të kritikuarit e fatkeqësisë së Republikës Islamike – dhe të pranuarit e heroizmit të pandërprerë të një kombi që fillimisht ka investuar shpresën e tij në të dhe tani po e lufton atë deri në fundin e hidhur – është një projekt përsosmërisht legjitim dhe fund e krye urgjent. Por t’i bashkohesh gllabërimit neokonservator të institucioneve demokratike të SHBA-së nga një bandë renegatësh militantë, dhe kësodore të ndihmohesh në sendërtimin e një kanoni letrar për perandorinë grabitqare, është një çështje krejtësisht tjetër. Në projektin e parë ti i rikthen dinjitetin dhe shpresën një kombi dhe rikthen qëndrësën e tij kulturore ndaj dominimit perandorak; në projektin e dytë ti orvatesh ta vjedhësh këtë dinjitet dhe shpresë prej tyre.

Problemi kryesor i *Reading Lolita in Tehran*, në fakt, shtrihet në shtrembërimin sistematik që ky libër i bën të historisë letrare dhe sociale iraniane, por, ç’është edhe më e rëndësishme, shtrihet në atë se sa krejtësisht shpërfillëse (indiferente apo moskokëçarëse) ndaj debateve masive të një lëvizjeje kundërkulturë në akademizmin amerikan, shkurtimisht i etiketuar *multikulturalizëm*, ka qenë Nafisi, duke i bashkuar kësaj forcë me qëndrësën konservatore të krahut të djathtë ndaj ndryshimeve kurrikulare në kolegjet dhe universitetet amerikane e evropiane, dhe, rrjedhimisht, edhe në mbarë botën. Nafisi nuk ka dhënë kurrë mësim në ndonjë kolegji apo universitet liberal artesh në Shtetet e Bashkuara. Ajo është krejtësisht injorante apo indiferente dhe armiqësore ndaj dekadave të përpjekjes që pakicat e raciaizuara dhe studimet e grave e të pakicave kanë pësuar për të lënë një gjurmë në tmerret kurrikulare të paketuara me zbrazëti të establishmentit të bardhë. Në një kohë kur i gjithë kombi është i angazhuar në një debat radikal në lidhje me domosdoshmërinë e diversitetit kurrikular, Azar Nafisi i bashkohet ardhës së elementëve më të këqinj reaksionarë që u thurin lavde “kryeveprave perëndimore”. Mbas dekadave të përpjekjeve të pandërprera, amerikanët indigjenë, afro-amerikanët, latino-amerikanët, aziatiko-amerikanët, feministet dhe një mori komunitetesh të tjera të denigruara dhe të zhveshura nga të drejtat e tyre i kanë vënë fre me sukses kanonit supremacist të mashkullit të bardhë në arsimin e lartë amerikan, kundër të gjitha gjasave, dhe me gjithë kundërvënien e fuqishme nga fundamentalizmi i krishterë dhe bastione të tjera që mbajnë në këmbë këtë perandori. Me një mospërfillje të plotë për këtë luftë në mbarë vendin, dhe në mbarë globin ç’është e vërteta, Azar Nafisi vendos sheshazi edhe një tjetër kulturë joevropiane jashtë vathës së letrares – jashtë vathës së sublimes dhe të së bukurës.

Duke u ofruar shërbimet e saj apo të tij perandorisë grabitqare, intelektualit apo intelektualja e shitur bën pjesën e tij apo të saj në normalizimin e qendrës perandorake dhe i shet kufijtë periferikë të kësaj perandorie si të çuditshëm, anormalë dhe groteskë. Nafisi shkruan për çudinë e të lexuarit të “Lolitës” në Teheran a thua se pritja e këtij libri në Shtetet e Bashkuara ka qenë një “buk’ e djath” proverbiale. Libri si dhe të dy përshtatjet e tij në film janë ndaluar apo bojkotuar sistematikisht që nga botimi i tij i parë në Francë në vitin 1955. Nabokov madje nuk arriti të gjente një botues amerikan që të ishte i gatshëm të rrezikonte me “Lolitën”. Aty nga viti 1954, së paku katër botues e kishin refuzuar Nabokovin. Përfundimisht, ai e çoi librin e tij në Evropë dhe i dha pëlqimin e tij Olympia Press të Maurice Girodias – botuesi i titujve pronografikë si “White Thighs (Shalë të bardha),” “With Open Mouth (Me gojë hapur),” and “The Sexual Life of Robinson Crusoe (Jeta seksuale e Robinson Kruzosë)” – që

të botonte vetëm 5.000 kopje të “Lolitës”.

Sa pa e marrë Graham Greene seriozisht “Lolitën” dhe sa pa publikuar një intervistë me Nabokov-in, askush në Europë apo SHBA nuk ishte i gatshëm që të shkruante një kritikë mbi librin në fjalë. Përkrahja që Greene i dha librit e zemëroi publikun britanik. John Gordon, redaktor i *Sunday Express*, e quajti “Lolitën” “libri më i ndyrë që unë kam lexuar ndonjëherë” dhe “pornografi e pastër e shfrenuar”. Ministria e Brendshme u dha urdhër doganierëve britanikë që të konfiskonin të gjitha kopjet që hynin në Mbretërinë e Bashkuar dhe ushtroi trysni ndaj ministrit francez të brendshëm që ta shpallte librin të ndaluar. Në vitin 1962, kur Stanley Kubrick publikoi përshtatjen që ai i bëri “Lolitës” për ekranin e madh ai u përball me politikat censuruese të *Production Code of Hollywood* (Kodi Producent (i censurës) i Hollywood-it) dhe të *Roman Catholic Legion of Decency* (Legjionit Katoliko Romak të Sjelljes së Hijshme). Vite më vonë, në vitin 1998, kur Lolita e Adrian Lyne u publikua, ai u shënjestrua nga konservatorët si në SHBA ashtu dhe në Europë. Ligjit i Megan i vitit 1994 në Nju Xhersi, Akti i Parandalimit të Pornografisë së Fëmijëve i vitit 1995, dhe vrasja e Jon Benet Ramsey në vitin 1996 u rikthyen sërish në debatin publik duke i vendosur të gjithë kundër “Lolitës” së Lyne.

Si një vepër letërsie, *Lolita* e Nabokov ka pësuar shumë lavde dhe dënime, përdorime dhe abuzime në mbarë botën – dhe të fabrikosh cudinë e qartë të të lexuarit të këtij libri në Teheran nuk është asgjë përpos ekzotizimit të një skene letrare përndryshe përsosmërisht kozmopolitane – një skenë e shtrembëruar dhe e përtallur pandërprerë nga Azar Nafisi.

Për të mbështetur legjitimitetin e perandorisë grabitqare, intelektualit i shitur duhet gjithashtu që të bëjë pjesën e tij apo të saj në riakreditimin e ideologëve deri më tani të diskredituar të projektit perandorak. Intelektuali i shitur flet me zërin e autenticitetit, autoktonisë, çudisë së orientalizuar. Ai është nga “atje”, kurse ajo “e di mirë se çfarë po thotë”, dhe kësaj zërat e tyre bartin autoritetin e një informatori autokton. Detyra më e dobishme e Nafisi-t ka qenë, pra, që të jetë një zë orientalist që akrediton orientalistin më të diskredituar ende gjallë – të vetmin orientalist të mbijetuar i cili i lidh shërbimet e tij me kolonializmin britanik dhe imperializmin amerikan në harkun kohor të një jete (ai është një artefakt i vërtetë muzeal). Marrëdhënia ndërmjet autores të *Reading Lolita in Tehran* dhe Profesorit Humbert Lewis të Orientalizmit është një marrëdhënie mjaft e ngrohtë dhe e mjegullt, reciprokisht mjaft e dobishme. Shumë kohë përpara se Bernard Lewis “të hapte derën” për Azar Nafisi-n dhe ta ngjyente *Reading Lolita in Tehran* me etiketën “kryevepër”, në një artikull infomercial që *The US News and World Report* botoi mbi orientalistin e moshuar (Jay Tolson, “A Sage for the Age: Bernard Lewis,” *The US News and World Report*, 12/3/2001) kjo ishte ajo që Azar Nafisi kishte për të thënë për Lewis:

“Kur unë po studioja asokohe në Shtetet e Bashkuara në vitet ‘70, unë isha tej mase kundër njerëzve si Lewis. Kisha shumë më tepër libra nga njerëz si Said. Kur u ktheva dhe jetova dhe dhashë mësim në Teheran në vitin 1979, fillova të zbuloj se sa shumë prej hamendësimeve të mia ishin të gabuara.” Duke lexuar Lewis, ajo zbuloi, ndër të tjerat, se myslimanët deri në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë kishin qenë shumë më kritikë ndaj kulturës së tyre se sa ç’kishte qenë cilido orientalist – një frymë autokritike për të cilën ajo kishte qenë e paditur deri sa Lewis dhe ‘orientalistë’ të tjerë e kishin çuar atë në këtë pikë iluminimi.

Në qoftë se Edward Said çmontoi ngrehinën e Orientalizmit, Azar Nasifi është rekrutuar për ta riakredituar atë. Është pikërisht për të njëjtën arsye që në pararendje të qëndrimit favorizues të Bernard Lewis, Azar Nafisi sigurohet që njëri prej karakterëve demoniakë që ajo portretizon në *Reading Lolita in Tehran* të jetë një përkrahës i flaktë i Edward Said-it — duke identifikuar kështu njërin prej intelektualëve më të shquar publikë të gjeneratës së tij me disa prej ndjesive më reaktive në një teokraci — e gjitha kjo për të kënaqur tektonikisht e Bernard Lewis dhe për të evokuar qëndrimin e tij

favorizues karshi një debutanteje neokonservatore.

Sa i përket thelbit të përkrahjes së Bernard Lewis, Azar Nafisi mund të jetë njëmend injorante për një numër gjërash – përfshirë edhe historinë intelektuale islame. Por të supozosh se përpara se Humbert Lewis dhe orientalist të tjerë mercenarë t'ua thoshin këtë gjë, myslimanët nuk ishin të vetëdijshëm për frymën e tyre autokritike, thjesht nuk është në kuadrin e arsyes. Si mund të ishin myslimanët autokritikë ndaj kulturës së tyre po të mos ishin të vetëdijshëm se ata kanë qenë autokritikë, dhe të prisnin ardhjen e orientalistëve që t'ua thonin atyre këtë gjë? Budallallëku i plotë këtij hamendësimi shkon në kundërshtim të plotë me arsyen dhe mendjen normale. Por citimi nga një orientalist që konfirmon urrejtnjen strukturore të një civilizimi nëpër troje e kultura të ndryshme shpaguhet me leverdi kur Lewis ia kthen nderin dhe e reklamon librin e Azar Nafisi-t si “një kryevepër” dhe lehtëson hyrjen e saj në qelitë e nëndheshme të pushtetit në Uashington D.C.

Të analizosh kulturën e imperializmit amerikan, sipas Amy Kaplan në *The Anarchy of Empire*, “është e nevojshme që të kapërcehen ... kufijtë dhe të sfidohet korniza interpretative e paradigmave kombëtare, të cilat e përdorin historinë për të fryrë egon tonë kombëtare.” Në mungesë të përkrahjes së brendshme apo legjitimitetit të jashtëm, perandoria amerikane tani mbështetet mbi një racë intelektualësh të shitur, mendje të pastreha, dhe “pishqollash” gati për t'u pajtuar me qira. E gjitha kjo për të fabrikuar menjëherë miratim, për të siguruar një kujtesë selektive, dhe për të mbajtur një amnezi kolektive shumë më jetëgjatë që ndoshta mund t'u shërbejë mjaft mirë qëllimeve imediate imperiale amerikane, por që, *ipso facto*, do të mbajë në këmbë forcën e saj vetë-shkatërruese të të ndërtuarit të kështjellave të rreme prej rëre pranë dallgëve faktike të historisë. Kjo perandori nuk ka për të zgjatur. Asnjë perandori nuk zgjat. Në qoftë se perandoritë do të zgjatnin, e gjitha bota sot do ishte duke folur persishten e lashtë.

Perktheu: Arjol Guni

* *Autori është Profesor i Studimeve Iraniane dhe Letërsisë Krahasimtare në Universitetin Columbia në New York. Ndër librat e tij më të mirë veçojmë Authority in Islam, Theology of Discontent, Truth and Narrative, Close Up: Iranian Cinema, Past, Present, Future, dhe një vëllim të edituar, Dreams of a Nation: On Palestinian Cinema (2006). Libri i tij i radhës Iran: A People Interrupted u botua në vitin 2006 nga New Press.*

Date Created

02/10/2018

Author

erasmusi